



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:221608

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06329661

KF.nr.502/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit “Erber” Sh.P.K. me NUI 8100210256 dhe seli në rr. ”Tirana” pn, Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” Sh.P.K. ,me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekti i çështjes rivlerësim malli, vlera e kontestit 4,296,8 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 11.10.2024 në prani të përfaqësuesit të palës paditëse Gentiana Behluli dhe përfaqësuesit të palës së paditur Mehdi Krasniqi, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Erber” Sh.P.K. me NUI 8100210256 dhe seli në rr. ”Tirana” pn, Prizren.
- II. MBETET NË FUQI Aktvendimi me nr.01.3.2.2/1497/15955 i datës 27.08.2021, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Erber” Shpk, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me kërkesë që të anulohet vendimi i kontestuar nr.01.3.2.2/1497/15955 i datës 27.08.2021, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Kodit Doganor, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe rritjes së pabazuar të bazës doganore. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor publik përfaqësuesi i palës paditëse ka theksuar se e paditura nuk ka marr

në konsideratë provat e paditësit dhe për vlerësimin e mallit ka përdorur metodën e të dhënave të disponueshme sipas katalogut gjerman duke aplikuar në mënyrë të gabuar nenin 35 të KDA-së edhe pse ky nen parasheh se të dhënat e disponueshme mund të përdoren në rast se importuesi këtu paditësi dështon që me anë të provave të mbështesë vlerën e deklaruar të mallit. Kërkesëpadinë e ka precizuar me kërkesë që të aprovohet kërkesëpadia e paditësi, të anulohet vendimi i kontestuar nr.01.3.2.21497/15955 i datës 27.08.2021, të obligohet Dogana e Kosovës ti kthej mjetet monetare të paguara me tepër në vlerë prej 4,296,8 euro.

E paditura në përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Më tej ka shtuar se vendimi i atakuar është marr konform dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi si të pabazuar dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm. Gjatës seancës së shqyrtimit kryesor përfaqësuesja e palës së paditur ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe sqarimeve dhe elaborimeve si në arsyetimin e aktvendimit kontestues. Ka shtuar se paditësi nuk ka paraqitur kontratë që lidhet mes shitësit dhe blerësit, kontratë e cila vërteton dhe dëshmon vlerën faktuale të eksportit të mallit e të cilën nuk i ka prezantuar as ekspertit financiar. Ekspertizën financiare e ka kundërshtuar, ndërsa lidhur me plotësimin e të njëjtës ka deklaruar se nuk është arrit që të sqarohet përse ka ardhë deri te një barazim apo një vlerë e një kontesti pa i përfillur rekomandimet e gjykatës, duke qenë një përsëritje e ekspertizës së parë me të vetmen shtesë ku thekson se i mungon dokumentacioni respektivisht DUD-at dhe faturat jokontestuese.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik ka administruar provat si në vijim: Aktvendimi nr. 01.3.2.2/1497/15955 i datës 27.08.2021, DUD R 56026 i datës 21.07.2021, Faturë nr.101001886 e datës 24.06.2021, DUD R56032 i datës 21.07.2021, Faturë nr. 101002008 i datës 08.07.2021, DUD R 56035 i datës 21.07.2021, Faturë 101002005 i datës 08.07.2021, DUD R 56041 i datës 21.07.2021, Faturë nr.101002006 i datës 08.07.2021, DUD R56042 i datës 21.07.2021, Faturë 101001668 i datës 17.06.2021, Deklarata Eksportuese i datës 19.07.2021, DUD R 51841 i datës 07.07.2021, Faturë nr.101001654 e datës 17.06.2021, DUD R 51843 i datës 07.07.2021, Faturë 101001888 e datës 24.06.2021 DUD R 51859 i datës 07.07.2021, Faturë 101001889 e datës 24.06.2021, DUD 51862 i datës 07.07.2021 Faturë nr. 95 e datës 02.07.2021, Deklaratë

eksportuese 05.07.2021, Transaksion bankar i datës 21.06.2021, Swift konfirmimi i datës 11.06.2021, Transaksion 00001741 i datës 06.07.2021, Swift konfirmimi i datës 24.05.2021, Transaksioni i datës 25.06.2021 dhe i datës 15.09.2021, Ankesë në doganë e datës 19.08.2021, Të dhënat nga katalogu SCHWACKE 22.07.2021, Ekspertizë financiare e datës. 10.05.2024 dhe plotësimi i ekspertizës i datës 31.07.2024 së bashku me dokumentacionin shtesë të dorëzuar nga eksperti.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, deklarimeve në seancë, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, dhe duke u mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar-administrativ, përfshirë deklaratimet në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimin kontestues dhe deklaratimet gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, gjykata ka konstatuar se nuk ishte kontestues fakti që paditësi, përmes DUD-ave: R-51841, R-51843, R-51862, R-56026, R-56032, R-56035, R-56041 dhe R-56042, ka deklaruar për zhdoganim mallin lëndor sipas dokumentacionit përkatës shoqëruës. Gjithashtu, nuk ishte i kontestueshëm fakti se e paditura ka kundërshtuar vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi dhe, si rezultat, përmes procesit të përcaktimit të vlerës së mallrave, ka caktuar një bazë të re doganore për mallin duke u bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit, sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109, përkatësisht në bazë të të dhënave të disponueshme nga katalogu gjerman Schwacke. Po ashtu, nuk ishte i kontestueshëm fakti që paditësi ka ushtruar ankesë në Doganën e Kosovës, e cila, me datën 27.08.2021, ka nxjerrë aktvendimin nr. 01.3.2.2/1497/15955 si akt administrativ përfundimtar në procedurën administrative të shkallës së dytë. Kundër këtij aktvendimi, paditësi ka iniciuar këtë kontest tregtar-administrativ përmes padisë së paraqitur më datën 04.10.2021.

Në mes të palëve mbetet kontestuese çështja nëse dokumentacioni i paraqitur në mbështetje të deklaratimit për zhdoganim ishte i harmonizuar, dhe nëse rivlerësimi i bërë nga e paditura ishte i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues, gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit me arsyetimin se vlera e deklaruar e mallit për zhdoganim është më e vogël se vlera

reale e paguar për mallin, gjë që sipas të paditurës është në kundërshtim me nenin 33 të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës. Për këtë arsye, Dogana ka përdorur metodën e gjashtë të vlerësimit për të caktuar vlerën e mallit bazuar në të dhënat e disponueshme, konkretisht nga katalogu Schwacke.net. Më tej, është arsyetuar se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti nuk është i mjaftueshëm për të vërtetuar vlerën reale të mallit, pasi mungon kontrata ndërmjet shitësit dhe blerësit, si dhe transferi bankar. Së fundi, lidhur me metodën e vlerësimit, është theksuar se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për të dëshmuar vlerën reale të transaksionit, dhe për këtë arsye vendimi i kontestuar është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 36 të KDA-së.

Gjykata, sipas propozimit të paditësit, ka aprovuar kërkesën për nxjerrjen e provës përmes ekspertizës financiare, duke caktuar ekspertin financiar R.B.. Detyrat e tij përfshinin: përcaktimin e saktë të detyrimeve doganore që paditësi duhej të paguante bazuar në vlerën e faturave të mallit, si dhe vlerën e detyrimeve doganore të caktuara nga Dogana pas rivlerësimit të mallit; përcaktimin e diferencës midis vlerës reale të faturës dhe asaj të përcaktuar nga Dogana; dhe verifikimin nëse vlera e deklaruar sipas faturave është paguar përmes transaksioneve bankare që gjenden në shkresat e lëndës.

Në ekspertizën financiare të datës 10.05.2024, eksperti ka konstatuar se subjekti ankimor ka bërë pagesat për 8 automjete kontestuese në data të ndryshme, për të cilat janë realizuar shitblerjet. Pagesat janë bërë në mënyrë të grupuar për disa automjete me një pagesë, duke përfshirë automjete që nuk janë objekt i ekspertimit. Identifikimi i pagesave është bërë përmes targave të regjistrimit. Sipas ekspertizës, diferenca e detyrimeve doganore midis përlllogaritjes së Doganës së Kosovës, bazuar në katalogun përkatës, dhe përlllogaritjes sipas faturave të mallit, është 22,577.68 euro - 18,258.80 euro = 4,318.88 euro.

Meqenëse ekspertiza e lartpërmendur nuk ishte e plotë, për shkak se nuk ishte bërë harmonizimi i faturave që nuk ishin objekt i kësaj lënde, eksperti u obligua ta plotësonte atë me dokumentacionin që gjykata i kërkoi paditësit të sigurojë, përfshirë DUD-at jokontestues të shoqëruar me faturat përkatëse.

Në plotësimin e ekspertizës, u konstatua se nga paditësi është siguruar DUD-i R-51859 dhe fatura 101001869 e datës 24.06.2021, e cila përfshin numrin e targës së veturës Mercedes nr. FE53EF

dhe librezën e qarkullimit, por dokumente të tjera nuk janë dorëzuar. Plotësimi rithekson se diferenca e paguar është 4,318.88 euro.

Gjykata nuk mundi t'i fal besimin e plotë ekspertizës financiare dhe plotësimit të saj, për shkak se nuk u arrit të konstatohet bindshëm se për mallin e deklaruar për zhdoganim është paguar vlera reale sipas faturave të blerjes. Mungesa e harmonizimit midis DUD-ave kontestues dhe atyre jokontestues ka penguar këtë konstatim. Si rezultat, pretendimi se faturat janë paguar dhe veturat e tjera të përfshira në mënyrë grupore nuk janë kontestuese, për gjykatën është i pamjaftueshëm për të kundërshtuar konstatimet e të paditurës, e cila, në mungesë të dokumentacionit të harmonizuar, ka rivlerësuar mallin sipas metodës së gjashtë, bazuar në të dhënat e disponueshme nga katalogu Schwacke.

Gjykata sqaron se me Dispozitën ligjore të nenit 33 par 1 të KDAK-së është përcaktuar se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*

Tutje, në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së përcaktohet se *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjete tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*. Ndërsa, se cilat dokumente duhet ti bashkëngjiten deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është e rregulluar me nenin 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, ku decidivisht përcaktohet se *“a) fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykatës i rezultoi një gjendje e njëjtë si ajo e konstatuar nga organi i paditur gjatë procedimit administrativ. Gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në procedurën administrative dhe në këtë konflikt administrativ është i pamjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paguar vlerën reale të mallit lëndor.

Gjykata nuk mund të pranoj si pagës te vlefshme transaksionin bankar për te cilën pretendon paditësi se është pagesa e mallit lëndor të deklaruar me DUD-at kontestues pasi që transferet bankare të datës 24.05.2021, 25.06.2021, 20.04.2021 janë transfere grupore për disa automjete e ku përfshihen edhe automjete të cilat nuk janë deklaruar për zhdoganim në rastin konkret e për të cilat nuk janë ofruar dokumentacionet e nevojshme siç janë faturat dhe DUD-at e në bazë të të cilave do të mund të vërtetohej se janë të harmonizuara dhe të mjaftueshme që të mund të pranohet deklarimi i zhdoganimit sipas metodës së parë të paraparë në Kodin Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.

Rrjedhimisht, në këtë drejtim gjykata nuk mund vërtetoj se është bërë në tërësi pagesa për mallin lëndor, andaj gjykata vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se vlera e mallit kontestues është vlerë reale pasi që paditësi nuk ka paraqitur prova bindëse dhe konkrete se malli lëndor është paguar sipas faturave të deklaruara.

Gjykata konstaton se pavarësisht pretendimeve të paditësit në padi, se të gjitha dokumentet e nevojshme për mallin lëndor janë paraqitur, sipas Nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr. 11/2009 për Implementimin e Kodi Doganor dhe Akcizave të Kosovës, gjen se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në këtë çështje tregtare administrative është i pamjaftueshëm për të vërtetuar vlerën reale të mallit lëndor, siç pretendon paditësi.

Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor. Pala paditëse edhe pse i ka prezantuar gjykatës provat materiale si faturat dhe transaksionet e administruara nga kjo gjykatë, megjithatë nuk ka arrit të dëshmoj pagesën e mallit lëndor si dëshmi se është deklaruar vlera reale e mallit doganor, prandaj gjykata konstaton se dokumentacioni përcjellës i mallit i paraqitur nga paditësi është provë e pa mjaftueshme për ti vërtetuar pretendimet se është paguar vlera reale e mallit lëndor.

Gjykata vlerëson se provat e përdorura për rivlerësimin e mallit lëndor, bazuar në të dhëna të disponueshme, katalogut Schwacke.net, përbëjnë një provë të vlefshme për vlerësimin e mallit sipas nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (Ligji 03/L-109). Prandaj, gjykata

konstaton se dispozitat ligjore janë aplikuar në mënyrë të drejtë gjatë rivlerësimit të mallit lëndor, sipas të dhënave të disponueshme.

Sipas nenit 43, par 1. i LKA-së, “Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”, andaj paditësi në këtë kontest tregtar administrativ ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tij në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsytimit ligjor dhe faktik të ankesës, ashtu siç parashihet me nenin Neni 81 F, paragrafi 1 dhe 81 E, paragrafi 4, pika 4 dh 5 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 .

Rrjedhimisht, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj thëniet e padisë nuk i aprovoj sepse i vlerësoj të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuara nga e paditura.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Nga të lartcekurat, Gjykata konform nenit 43 par. 1, dhe nenit 46, par. 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.502/22, datë 11.10.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.